



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 1349 prot.

Pukë më, 03 10, 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Date ____ / 10/ 2024.

PËR
“VENDOSJE MEMORIALI”

Në mbështetje të:

- Nenit 8 pika 2, neni 54, nenit 55, të ligjit nr.139/2015 ”Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar),
- Nenit 20 pika 3 dhe 5, të Ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e Vetqeverisjes Vendore”,
- Ligjit nr. 107/2014 ”Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar),
- Si dhe në relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë në mbledhjen e datës _____/10/2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Këshilli i Bashkisë

VENDOSI:

1. Të miratojë vendosjen e Memorialit në rreth të martirëve të malsisë:

- Ndrek Markiqi, Ndue Dashi, Dedosh Jaku nga Berisha!
- Qun Gjergji nga Midha
- Hil Caka nga Dushi Kqire

Vendi i vendosjes së Memorialit do jetë pranë sheshit qendror “Gjergj Kastrioti - Skenderbeu”, në lulishten pranë godinës së n/Prefekturës, sipas planvendosjes bashkëlidhur,

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Pukë

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 ”Për vetëqeverisjen Vendore”

Hartuesi

Drejtoria e Plan. të territorit
Ing.Lindita Hyseni

Juristi

Aida Sinani

KRYETARI
RROK DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

R E L A C I O N

**MBI PROJEKT VENDIMIN PËR “EMËRTIM RRUQE NË TERRITORIN E BASHKISË
PUKË”**

PËR KËSHILLIN BASHKIAK

Pukë me _____. 10. 2024

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të:

- Nenit 8 pika 2, nenit 54, nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" (i ndryshuar),
- Nenit 20 pika 3 dhe 5, të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e Vetqeverisjes Vendore",
- Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar),

Kryetari dhe Administrata e bashkisë propozon që këshilli i Bashkisë Pukë të miratojë vendosjen e Memorialit në nder të martirëve të malsisë:

- Ndrek Markiqi, Ndue Dashi, Dedosh Jaku nga Berisha!
- Qun Gjergji nga Midha
- Hil Caka nga Dushi Kqire

Vendi i vendosjes së Memorialit do jetë pranë sheshit qendror "Gjergj Kastrioti - Skenderbeu", në lulishten pranë godinës së n/Prefekturës, sipas planvendosjes bashkëlidhur,

Me vendimin e këshillit të bashkisë nr. _____ datë _____ u shpallen Qytetar Nderi të bashkisë Pukë.

Historiku:

VATAJT E BERISHËS, NË MARATONËN E LIRISË !

Rrugëtimi i lirisë për Shqiptarët në tërësi dhe Berishasit në veçanti është stafetë. Pjesë e pandarë e kësaj stafetë, e këtij rrugëtimi për liri është edhe Familja e Vata-jve në lagjen Desk, të fshatit

Katund i Kishës, në Berishë të Pukës me tre djemtë e Markiq Dodës (1851-1916): Vëllezërit Ndrek Markiqi (1887-1926); Dedë Markiqi (1893-1974); Prendush Markiqi (1891-1951). Kulla e tyre gjendet rrëth 300 m nga shkolla e fshatit dhe rrëth 100 m nga Kisha e 'Alshiqës" në lindje, rrëth 500 m nga "Shpella e Deskut".

Populli i Berishës është liridashës dhe arsimdashës, në dokumentat arkivore ndër përkrahësit e parë të shkollës së Iballës në vitin 1903, ishin edhe krerët e Berishës, Markiq Doda, Mëhill Shpendi, si dhe Pjetër Ndëre Prendi. Pjetër N. Prendin bashkë me "Dëshmorin e Atdheut", Mëhill Mark Dedën pushtuesi i ndoqi këmba këmbës dhe, pas një qëndrese heroike u vranë në Mollë të Shoshit.

Në vitin 1912 në Pukë ishte përqendruar ushtria e madhe e Shefqet Turgut Pashës me mbi 6 mijë ushtarë. Për ti bërë ballë kësaj ushtrie Gasper Thaçi organizon në mars të këtij viti një mbledhje në shtëpinë e Bajraktarit të Bugjonit Frrok Kol Bajraktari, ku diskutimi kryesor ishte gjetja e mundësive përfurnizimin e popullit me armë, për ti bërë ballë pushtuesit. Në mes patriotëve të tjerë merr pjesë edhe Ndrek Markiqi. Në dokumentat e A.Q.SH , dhe në librin e autorit Paulin Margjokaj shpjegohet se pas një pune të mirë preqatitore e të drejtuar nga Gasper Thaçi me 12 qershorit 1912 në Qelëz tek Kisha u mblohdhën krerët e viseve të Pukës dhe mbi 400 trima të këtyre krahinave, prej ku do të fillonte mësymja përvavarësimin e Pukës. Nga Berisha ishin krerët Prend Uka, Ndreka Markiqi, Gjok Marashi , Pal Ndou, Mehill Shpendi, Ndoc Mark Deda me çetën e tij, Tish Toma i Midhës, etj., të cilët bashkë me çetat e tjera të trevës së Pukës do të zhvillonin një betejë 3-ditore për çlirimin e saj, që në histori do të njihje si "Lufta e Midhës" e cila përbën një epope të lavdishme të popullit Pukjan përliri e Pavarësi.

Studiuesi, Xhemal Meçi (Mjeshtër i Madh) shpjegon se në vitin 1926 populli i Pukës ishte i pakënaqur, sepse nuk iu falën taksat ashtu si Mirditës dhe Dukagjinjt, kur tradicionalisht, Puka nuk kishte paguar taksa dhe kishte mbajtur armët në kuadrin e një autonomie qindra vjeçare të njojur si autonomia e Maleve shqiptare. Prandaj mjaft përfaqësues nga krente e masave popullore protestuan në prefekturën e Shkodrës, por edhe në Tiranë deri tek Ministri i Brendshëm. Megjithë uljen apo heqjen e disa prej ketyre taksave populli nuk u pajtua dhe pakënaqësia u rrit në vazhdim dhe filloj të përhapej me gjerë në malësi. Kjo pakënaqësi u shfrytëzua nga grupime të ndryshme politiko shoqërore. Në këto rrethana qeveria e Ahmet Zogut mori masa të shpejta dhe të ashpra. Në mungesë të një xhandarmërie të mjaftueshme si dhe të një ushtrie të aftë të kontrollonte e të mbronte kufijtë, u thirren vullnetare Zogist nga Dibra e Luma. Rezistenza e fortë nga grupet kryengritëse, e shtoi dhunën shtetërore edhe masat e konfiskimit të pasurisë të fshatrave të Berishës dhe të Iballës.

Kjo Kryengritje pati me dhjetar të denuar me vdekje dhe me qindra me burgim. Kronologjia e kryengritjes së vitit 1926, e jep bashkëkohësi Camillo Libardi . Të parët që u varën ishin ata nga Berisha Ndrek Markiqi, Ndëre Dashi nga fshati "Katund i Kishës" Berishë, dhe u varen tek sheshi i quajtur "Teqe" në Pazar. Vellai i Ndrek Markiqit dhe Ndëre Dashit ishin nisur përi

vizituar në burg. Pa ditur se i kishin varur, u ndeshën në turmën që po vraponte në pazar për të parë këtë ngjarje tragjike. Ngriten sytë dhe kë panë të varur në atë tra të tmerrshëm ?, vëllezërit e tyre. Vëllai i Ndue Dashit shqiptoi disa fjalë me një dhimbje të tmerrshme. Vellai i Ndrek Markiqit u zverdh dhe bërtiti: "Pushka dhe litari për trimat janë". Ata patën të gjitha shërbimet fetare dhe u varrosën në varrezat e quajtura "Rramajeve". Çun Gjergji i Midhës dhe Dedosh Jaku nga Levosha e Berishës, u varen të "Fusha e Druve" dhe u varrosën pranë shokëve të tyre. Pas varjes së atyre të Bërichës u erdhi rradha atyre të Thethit e të tjerët me rradhë përfshirë edhe Don Gjon Gazulli, prifti i Komanit, për të cilin u bë e pa mundura, për ta shpëtar, Ipeshvi i tij shkoi personalisht tek Ahmet Zogu dhe nuk arriți të bëjë gjë. Ipeshkvi i Dukagjinit, At Benardin Shllaku nuk la gjë pa bërë për ta shpëtar dhe nuk ja arriți. Ndër të burgosurit 75- vetë u dënuan me nga një deri në 101-vjet burg, shumë prej të cilëve ishin edhe nga nënprefektura e Pukës, të cilët për herë të parë po i prezantojmë për publikun e gjerë.

Berishasi Nikoll Pjetra i vitelindjes 1937, studiues dhe autor i disa veprave në librin e tij "Berisha-1", i kushton një pjesë të veçantë Kryengritjes së Berishës së vitit 1926. Ai, shpjegon së bërthamën kryesore të opozitës së asaj kohe, kundër Ahmet Zogut e përbënин: Ndrekë Markiqi, Dedosh Jaku, Ndue Dashi, të cilët kishin një bashkëpunim të ngushtë me shumë Berishas të tjerë, si: Koc Marku; Çun Kola; Mëhill Shpendi; Ndoc Nika; Palë Ndou; Marash Nik Marku; Kol Frroku; Kol Gjoka; Kurt Gjoni; Mark Koliku; Mark Baleci; Prend Zeka; Hilë Lleshi; Mark Frroku, etj. Zogu, kishte marrë informacion për opozitën e fuqishme të patriotëve të Berishës, të cilët kishin të drejta e liri të trashëguara në shekuj si për vetëqeverisjen ashtu dhe për mos pagimin e taksave. Autori në këtë libër na jep edhe portretet e këtyre "3- Martireve" të varur në litar:

Ndrekë Markiqin, ka pasur trup mesatar e jo i shëndoshë, por i pashëm dhe energjik në kuende, e nga ndonjëherë edhe i rrembyer. Alltinë e mbante gjithmonë në brez e me fishekë në të.

Ndue Dashi, ka qenë shtatlartë dhe i shëndoshë. Dallohej nga veshja . Ai, mbante kapuç të bardhë, tirqe , xhamdan Gjakove, sahat xhepi me çystekë prej argjendi, brez me ngjyrat e bukuratë përuara për merak. Pinte duhan me letër të bardhë, por edhe me qelibarë. Fjala e tij dëgjohej në kuende.

Dedosh Jaku, ka qenë shtatëlartë e i mençur, i veshur mirë ashtu si dy të parët.

Rrugëtimi i lirisë për familjen fisnike Markiqi Dodë Vata qe një maratonë e gjatë dhe e dhimshme. Me instalimin e regjimit të realizimit socialist pas Luftës së dytë botërore në Shqipëri të qenurit si Vojvod, një derë e madhe e shqiptarisë nuk do të shihej me sy të mirë dhe menjëherë do të fillojë goditja e saj. I gjendur nën trysinë e regjimit në vitin 1948 Dodë Ndrek Markiqi do të arratisëj por bijtë e tij ndonëse larg atdheut: Biba; Ndoja; Zefi nuk reshtën së punuari për vendin e tyre.

Prendush Markiqi, në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore ishte kryeplak i fashatit Berishë. Ai, ndrron jetë në një moshë realivisht të re (1945) duke lënë një vajzë Lenen dhe një djali Kolën, i cili la psë vajza; Dashe; Lezen; Shpresën; Shota; Vera dhe një djali Zanin.

Dede Markiqi, me shumë vuajtje, sakrifica dhe presionin e regjimit të kohës e ndërtoj jetën e tij në trojet e të parëve në Alshiqe. Në vitin 1945, për bashkëpunim me Pashk Bibë Miraken u arrestua dhe pas një viti hetuesie në Shkodër u lirua si i pafajeshem. Me arratisjen në vitin 1948 të nipi të tij Dodë Ndrek Markiqi, në vitin 1949 Dedë Markiqi arrestohet dhe denohet me 4-vjet heqje lirie deri në vitin 1953, për tentativë arratisje

Ai, pati dy djem Gjoka dhe Marku. Gjoka (1939-2013), i cili pa «triske fronti» dhe me refuzimin e futjes në Kooperative Bujqësore, e kaloi shumicën e jetës në burgjet dhe kampet e internimit, deri me ardhjen e pluralizmit në Shqipëri.

Marku (1934-2020). Në vitin 1969 për mos pranim për futjen në Kooperativ Bujqësore u dënuar me burgim dhe konfiskim pasurie, pas daljes nga burgu punoi në koperative bujqësore deri në vitin 1990 ku dhe doli në pension, kohë në te cilën u mor me aktivitet social-shoqërore kryesishët ato të pajtimit të konflikteve.

Maratona e lirisë për këtë familje fisnike që e gjatë dhe e mundimshme. Ajo, i ka fillesat e saj që në fillimet e shekullit të XX me të parin e saj Markiq Doda me kontributë në hapjen e shkollës shqipe në Iballë të Pukës në vitin 1903 e para në këto vise, dhe ndërtë parat në Shqipëri. Më tej ajo, ka vazhduar me krengritjet për liri e pavarësi kombëtare dhe në rujatjen e autonomisë së malësorëve duke kulmuar në kryengritjen e vittit 1926. Mori goditjen e rëndë me instalimin e regjimit të realizmit socialist duke e lëshuar në gjendje agonie, e cila vazhdoi deri në vitet 1990 me vendosjen e pluralizmit kohë në të cilën kjo familje u ridimensionua duke shpërthyer si një zambak i lirisë së munguar.

BIBLIOGRAF:

-A.Q.SH; - Paulin Margjokaj; -Xhemal Meçi ; -Camillo Libardi; -Nikoll Pjetri; -

Autori: Ing. Kol Dedaj-Studiu, Tiranë, datë 12.11.2023

Konspektoi: ing. L. Hyseni

KRYETARI

RROK DODA



Hartografia: Plani i vendosjes se Memorialit

